

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga NLB Skladi – Zeleni prehod I A, namenska druzhba za nalozhbe, d.o.o. (shoqëri me qëllim të posaçëm për investime), me seli në Tivolska cesta 48, 1000 Lubjanë, Slloveni, përmes Shoqërisë së Avokatëve Knezoviq dhe bashkëpunëtorët nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 04.06.2025, solli këtë

### AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin NLB Skladi – Zeleni prehod I A, namenska druzhba za nalozhbe, d.o.o., me seli në Tivolska cesta 48, 1000 Lubjanë, Slloveni, do të fitojë kontroll mbi shoqërinë RESALTA GRADSKO OSVETLUVANJE I ENERGETSKA OBNOVA NA ZGRADI D.O.O. BEOGRAD (RESALTA NDRIÇIMI I QYTETIT DHE RINOVIMI ENERGETIK I NDËRTESAVE SH.P.K. BEOGRAD) me seli në Beograd, Braça Baruh 24, Republika e Serbisë, edhe bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, **dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria për pagesë 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

### A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 04.06.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftim për përqendrim nga NLB Skladi – Zeleni prehod I A, namenska druzhba za nalozhbe, d.o.o., me seli në Tivolska cesta 48, 1000 Lubjanë, Slloveni, me të cilin NLB Skladi – Zeleni prehod I A, namenska druzhba za nalozhbe, d.o.o., do të fitojë kontroll mbi RESALTA GRADSKO OSVETLUVANJE I ENERGETSKA OBNOVA NA ZGRADI D.O.O. BEOGRAD me seli në Beograd, Braça Baruh 24, Republika e Serbisë, përmes shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcave të bashkangjitura me të, konstatoi sa vijon:

**Veprimtaritë themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:**

**NLB Skladi – Zeleni prehod I A, namenska druzhba za nalozhbe, d.o.o.**, është pjesë e NLB Grupit.

NLB Grupi është grup udhëheqës bankar dhe financiar. Përveç NLB, si subjekt kryesor në Slloveni dhe shoqëri publike, NLB Grupi përbëhet nga gjashtë banka-bija dhe disa kompani për shërbime të tjera financiare dhe ndihmëse (menaxhim me mjete, lizing, menaxhim me pasuri të paluajtshme etj.).

NLB Grupi përdor model universal të bankave dhe i mbështet klientët e tij përmes shërbimeve për persona fizikë, bankave korporative dhe investive.

NLB Grupi në Maqedoninë e Veriut aktualisht ka 3 shoqëri të lidhura:

- NLB Banka SHA Shkup me seli në rr. Vodnjanska nr. 1 Shkup, me veprimtari prioritare - ndërmjetësim tjetër monetar,
- Shoqëria për lizing NLB LEASE&GO SHPK Shkup me seli në rr. Vodnjanska nr. 1 Shkup, me veprimtari prioritare lizing financiar, dhe
- Shoqëria për menaxhim me fonde të hapura dhe të mbyllura investive NLB Fonde SHA Shkup me seli në bul. Partizanski odredi nr. 14A-1/2 Shkup me veprimtari prioritare: veprimtari të menaxhimit me fonde.

**Veprimtaria e regjistruar e RESALTA GRADSKO OSVETLUVANJE I ENERGETSKA OBNOVA NA ZGRADI D.O.O. BEOGRAD** është aktivitete inxhinierike dhe këshillim teknik.

RESALTA GRADSKO OSVETLUVANJE I ENERGETSKA OBNOVA NA ZGRADI D.O.O. BEOGRAD nuk ka subjekte të lidhura të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe as nuk ka realizuar qarkullim në vitin 2024 në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, sepse plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

**Udhëzim për mjetin juridik:**

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**

**KRYETARE**

**Mr. Малинка Силјановска Николиќ**